

VENDIM
Nr. 481, datë 25.7.2012

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SIGURINË E PUBLIKUT NDAJ
EKSPOZIMEVE QË SHKAKTOHEN NGA BURIMET E RREZATIMEVE
JONIZUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I
SALI BERISHA

**RREGULLORE PËR SIGURINË E PUBLIKUT NDAJ EKSPOZIMEVE QË
SHKAKTOHEN
NGA BURIMET E RREZATIMEVE JONIZUESE**

1. Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese, të detyrueshme për zbatim në të gjitha veprimtaritë e përcaktuara me ligj.

2. Përgjegjësitë e personave fizikë e juridikë të licencuar

2.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar për ushtrimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues zbatojnë kërkesat e rregulloreve dhe të standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, për çdo ekspozim të publikut që shkaktohet nga praktika ose burime për të cilët ata janë përgjegjës. Personat fizikë e juridikë të licencuar zbatojnë kërkesat e përcaktuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për ekspozimet ose burimet mbi nivelet e përjashtimit, qofshin dhe ekspozime ose burime natyrore.

2.2 Personat fizikë e juridikë të licencuar janë përgjegjës për burimet nën përgjegjësinë e tyre, për përgatitjen dhe zbatimin e:

- a) politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, sistemit procedural dhe organizativ në lidhje me ekspozimin e publikut në përmbushje të kërkesave të standardeve;
 - b) masave që sigurojnë:
 - i) optimizimin e mbrojtjes së publikut, ekspozimi i të cilit lidhet me këto burime; dhe
 - ii) kufizimin e ekspozimit normal për grupet kritike përkatëse që lidhet me këto burime, në mënyrë që ekspozimi total të jetë jo më i lartë se doza kufi për publikun.
- Në zgjedhjen e grupeve kritike duhet të merren parasysh të gjithë brezat e tanishëm ose të ardhshëm në vendet ku ndodhen burimet apo dhe në vende të tjera;
- c) mundësisë që ekspozimi i publikut të kontrollohet në përputhje me kërkesat e standardeve;
 - d) ndërtesave, pajisjeve dhe shërbimeve të përshtatshme dhe bashkëkohore për mbrojtjen e publikut, natyra dhe shtrirja e të cilave janë në përpjesëtim me vlerën dhe mundësinë e ekspozimit;
 - e) trajnimeve të përshtatshme për mbrojtjen dhe sigurinë e personelit, i cili ka funksione që lidhen me mbrojtjen e publikut, si dhe të trajnimeve periodike dhe bashkëkohore, me qëllim që të sigurojnë nivelin e nevojshëm të kompetencës;

f) pajisjeve monitoruese të përshtatshme dhe të programeve mbikëqyrëse për të vlerësuar ekspozimin e publikut sipas kërkesave të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet; g) regjistrimit të të dhënave të inspektimeve dhe monitorimeve;

h) planit dhe procedurave të emergjencave, në përputhje me natyrën dhe madhësinë e riskut dhe mbajtjen e tyre në gatishmëri për t'i aktualizuar në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencës.

2.3 Personat e licencuar janë përgjegjës për të siguruar që procesi i optimizimit për masat e kontrollit të shkarkimit të lëndëve radioaktive nga vendi i ruajtjes në mjedis është subjekt i dozave shtrënguese, duke marrë parasysh:

a) kontributin e dozës nga burime dhe praktika të tjera;

b) ndryshimet e mundshme të ndonjë kushti, i cili mund të ndikojë në ekspozimin e publikut, ndryshimet në karakteristikat dhe punën me burimet, ndryshime në mënyrat e ekspozimit, ndryshime në mënyrën e jetesës dhe të shpërndarjes së popullsisë, modifikimin e grupeve kritike ose ndryshime në kushtet e mjedisit;

c) praktikën më të mirë në punën me burime ose praktika të ngjashme.

2.4 Nëse një praktikë ose një burim brenda praktikës shkarkon lëndë radioaktive në mjedis, që mund të shkaktojë ekspozim të publikut në një vend të ndryshëm nga vendi ku praktika ose burimi është vendosur, kërkohet optimizimi dhe kontrolli i shkarkimeve.

3. Kontrolli i vizitorëve

3.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar në bashkëpunim me punonjësit:

a) do të sigurojnë informacionin dhe instruksionet e nevojshme për vizitorët para hyrjes së tyre në zonat e kontrolluara, në mënyrë që të sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme të vizitorëve dhe të individëve të tjerë, të cilët mund të ndikohen nga veprimet e tyre;

b) do të sigurojnë që vizitorët të jenë shoqëruar në çdo zonë të kontrolluar nga një person që ka njohuri për masat mbrojtëse dhe të sigurisë në këto zona;

c) do të sigurojnë vendosjen e një kontrolli për hyrjen e vizitorëve në zonat e mbikëqyrura dhe vendosjen e shenjave të përshtatshme në këto zona.

4. Burimet e ekspozimit të jashtëm

4.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar në rastin kur një burim i rrezatimit të jashtëm mund të shkaktojë ekspozim të publikut sigurojnë:

a) kryerjen e ekspertizave të pavarura përpara fillimit të punës për planimetritë e mjedisit dhe sistemimin e pajisjeve për të gjitha instalimet e reja dhe për të gjitha modifikimet e rëndësishme në instalimet ekzistuese që përdorin burime të rrezatimit të jashtëm;

b) vendosjen e dozave shtrënguese për punën e këtyre burimeve;

c) optimizimin e mbrojtjes nga rrezatimet.

5. Ndotjet radioaktive në hapësira të mbyllura

5.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar sigurojnë që:

a) për burimet për të cilat ata janë përgjegjës, masat për mbrojtje të jenë optimizuar në përputhje me kërkesat e standardeve;

b) zbatojnë kërkesat për të parandaluar shpërndarjen e ndotjeve në zonat ku ndodhet publiku.

6. Mbetjet radioaktive

6.11 Personat fizikë e juridikë të licencuar:

a) sigurojnë që aktiviteti dhe volumi i çdo mbetjeje radioaktive që rezulton nga burimet për të cilat ata janë përgjegjës, të mbahet në minimumin e mundshëm dhe që mbetjet të menaxhohen (grumbullohen, trajtohen, kondicionohen, transportohen, ruhen dhe depozitohen) në përputhje me rregulloren për menaxhimin e sigurt të mbetjeve;

b) ndajnë dhe trajtojnë veçmas, kur është e nevojshme, llojet e ndryshme të mbetjeve

radioaktive. Për ruajtjen e përkohshme deri në depozitimin përfundimtar, merren në konsideratë faktorë të ndryshëm të tillë si përmbajtja e radionuklidit, perioda e përgjysmimit, përqendrimi, vëllimi dhe vetitë fizike dhe kimike.

7. Shkarkimi i lëndëve radioaktive në mjedis

7.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar sigurojnë që lëndët radioaktive nga burimet dhe praktikat e licencuara nuk duhet të shkarkohen në mjedis derisa:

- a) shkarkimi është brenda kufijve të shkarkimit të autorizuar;
- b) shkarkimet janë të kontrolluara;
- c) ekspozimet e pritshme të publikut nga shkarkimet janë të kufizuara në jo më shumë se 10 mikroSivert në vit;
- d) kontrolli i shkarkimeve është optimizuar në përputhje me kërkesat kryesore të standardeve.

7.2 Personat fizikë e juridikë të licencuar, përpara se të fillojnë shkarkimin në mjedis të lëndëve radioaktive të ngurta, të lëngëta ose të gazta nga burimet që janë nën përgjegjësinë e tyre:

- a) përcaktojnë karakteristikat dhe aktivitetin e materialeve që do të shkarkohen, pikat e mundshme dhe mënyrat e shkarkimit;
- b) përcaktojnë nëpërmjet studimeve paraprake të përshtatshme, të gjitha rrugët e ekspozimeve të rëndësishme nëpërmjet të cilave shkarkimet e radionuklideve kontribuojnë në ekspozimin e publikut;
- c) vlerësojnë dozën në grupet kritike, që vjen nga shkarkimet e planifikuara;
- d) paraqesin këtë informacion te Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

7.3 Personat fizikë e juridikë të licencuar, gjatë kohës së punës me burimet që janë nën përgjegjësinë e tyre:

- a) mbajnë, në nivelet më të ulëta të mundshme, të gjitha shkarkimet radioaktive nën kufijtë e autorizuar të shkarkimeve;
- b) monitorojnë shkarkimin e radionuklideve për të treguar përputhjen me kufijtë e autorizuar të shkarkimeve;
- c) regjistrojnë rezultatet e monitorimit;
- d) raportojnë rezultatet e monitorimit te Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

7.4 Personat fizikë e juridikë të licencuar, rishikojnë dhe rregullojnë masat kontrolluese të shkarkimeve të tyre nga burimet nën përgjegjësinë e tyre në bazë të eksperiencës së punës, duke marrë parasysh çdo ndryshim në rrugët e ekspozimit dhe në përbërjen e grupeve kritike që mund të ndikojnë në vlerësimin e dozave që vijnë nga shkarkimet.

8. Monitorimi i ekspozimit të publikut

8.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar:

- a) përgatitin dhe zbatojnë një program monitorimi për sa i përket ekspozimit të publikut ndaj rrezatimeve të jashtme;
- b) përgatitin dhe zbatojnë një program monitorimi që të sigurohen se kërkesat e standardeve për shkarkimin e lëndëve radioaktive në mjedis mbeten të vlefshme për të bërë të mundur vlerësimin e ekspozimit të grupeve kritike;
- c) mbajnë të dhëna të përshtatshme për rezultatet e programeve të monitorimit;
- d) paraqesin një raport përmblledhës të rezultateve të monitorimit në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

9. Produktet e konsumit

9.1 Produktet e konsumit që mund të shkaktojnë ekspozim ndaj rrezatimit, shpërndahen në publik kur plotësojnë kërkesat e përcaktuara në rregullore të veçanta;

9.2 Furnizuesit e produkteve të konsumit të papërfjashtuara sigurojnë që këto produkte plotësojnë kërkesat e standardeve për sa i përket projektimit dhe prodhimit të tyre, të cilat mund të ndikojnë në ekspozimin e publikut gjatë përdorimit, duke mbajtur parasysh:

- a) radionuklidet që mund të përdoren, aktiviteti, llojet e rrezatimeve, energjitë si dhe periodat e përgjysmimit të tyre;
- b) format fizike dhe kimike të radionuklideve;
- c) kufizimin dhe mbrojtjen e materialit radioaktiv në produktet e konsumit

d) eksperiencën që lidhet me produkte konsumi të ngjashme.

9.3 Furnizuesit e produkteve të konsumit që përmbajnë lëndë radioaktive shtesë sigurojnë që të vendosin një etiketë të lexueshme mbi sipërfaqen e dukshme në çdo produkt konsumi, duke treguar:

- a) lëndën radioaktive që përmban produkti;
- b) autorizimin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për shitjen e produktit në publik.

9.4 Furnizuesit e produkteve të konsumit duhet të japin informacione dhe instruksione të qarta dhe të përshtatshme për çdo produkt lidhur me:

- a) instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e saktë të produktit;
- b) shërbimin dhe riparimin e tij;
- c) radionuklidet që përmbahen dhe aktivitetet e tyre në një datë të caktuar;
- d) fuqinë e dozës së rrezatimit gjatë operimit normal si dhe gjatë shërbimit dhe riparimit;
- e) rekomandime për procedurat e trajtimit pas kthimit të tyre në mbetje.